

Nr. Prot.

Vlorë, më 13.06.2017


Vendim
Nr. 66, datë 13.06.2017

**PËR SAKTËSIMIN DHE PLOTËSIMIN E DETYRAVE TË VENDIT TË PUNËS
SË KONSULENTËVE TË JASHTËM (ME KOHË TË PJESSHME) NË
SEKTORIN E KARRIERËS AKADEMIKE**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 93 në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Senatit Akademik, nr. 10, datë 27. 01. 2017, në referencë të parimeve bazë të përgjithshme të *Kartës Evropiane të Kërkuesve*, dokument i mbështetur nga UV përmes Letrës Zyrtare Mbështetëse, nr. 1314 prot, datë 05.10.2016, (shih për më shumë: https://euraxess.ec.europa.eu/jobs/charter/declaration-endorsement#show_Albania), si dhe në funksion të plotësimit dhe përmirësimit të përshkrimit të pozicionit të punës të specialistëve me kohë të pjesshme që këshillojnë dhe asistojnë zhvillimin e karrierës akademike dhe mentorimin e kërkuesve në përgjithësi dhe atyre të rinj në veçanti, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.06.2017

VENDOSI:

1. Saktësimin dhe shtjellimin me hollësi të detyrave të konsulentëve për kualifikimin e personelit akademik, pjesë e Sektorit të Karrierës Akademike, referuar strukturës organizative dhe organigramës së UV-së.
2. Konsulentëve si pjesë e këshillimit për kërkuesit e rinj në UV ju caktohen detyra dhe nëndetyra specifike në kuadër të funksionit të tyre brenda pozicioneve referuar strukturës organizative.
3. Konsulentët kanë për detyrë të këshillojnë kërkuesit e rinj të UV-së periodikisht në drejtimet që lidhen me:
 - a) Kualifikimin dhe promovimin individual akademik.
 - b) Botimin e punëve shkencore në revista dhe buletine cilësore kombëtare e ndërkombëtare, me autoritet e faktorë të lartë impakti.
 - c) Organizimin dhe pjesëmarrjen në konferenca, seminare, *workshop*-e dhe takime me natyrë akademike e universitare, në aktivitete kombëtare dhe sidomos ndërkombëtare.
 - d) Aspekte pedagogjike dhe mësimdhënëse me studentët.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- e) Përmbajtjen e ligjit të arsimit të lartë, akteve nënligjore, statutit të institucionit edhe rregulloreve të fakulteteve/departamenteve etj.
 - f) Ndryshime të mundshme në legjislacionin e sipërpërmendur në shkronjën e).
 - g) Kushtet e punës dhe kërkimit shkencor teorik dhe aplikativ.
 - h) Infrastukturën fizike në institucion dhe jashtë tij.
 - i) Përfshirjen në projekte vetjake dhe institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare.
 - j) Konsulenca dhe ndihmesa me karakter administrativ.
 - k) Çdo aspekt tjetër me rëndësi pedagogjike, ligjore, administrative dhe shkencore që kontribuon në përmirësimin e objektivave kualifikuese, kërkuese e publikuese.
4. Detyrat e mësipërme i shtohen përshkrimit të vendit të punës së specialistëve të jashtëm në Sektorin e Karrierës Akademike.
 5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Rektori, Zv/rektori për Komunikim e Zhvillim Institucional dhe Sektori i Burimeve Njerëzore.
 6. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.
 7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI



Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.